



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 21.7.2023

Nr: 711

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË PËRMET, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË", ZJ. VALBONA XHEKSON MUHAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1829 prot., datë 11.7.2023, Këshilli i Bashkisë Përmet, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Elton Shkëlqim Hysenshahaj, propozuar nga subjekti politik "Partia Demokratike e Shqipërisë".

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e "Partisë Demokratike të Shqipërisë", për Këshillin e Bashkisë Përmet, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 2, zj. Valbona Xhekson Muhaj.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit "Partia Demokratike e Shqipërisë", ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 19921 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.



Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Valbona Xheksion Muhaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile si dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Valbona Xheksion Muhaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Valbona Xheksion Muhaj, në Këshillin e Bashkisë Përmet, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Valbona Xheksion Muhaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Valbona Xheksion Muhaj, në Këshillin e Bashkisë Përmet, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

#### **V E N D O S:**

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Përmet, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, zj. Valbona Xheksion Muhaj.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**